REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA

Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 te Statutit të Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008 e në mbështetje të nenit 14 paragrafi 5, lidhur me paragrafin 7, dhe 8, pika 1, 2 dhe 3, të Rregullores (QRK) Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimor dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë 31.08.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit përzgjedhës

Neni 1

1.1 Formohet komisioni përzgjedhës për intervistimin me shkrim dhe me gojë te kandidatëve që kanë konkurruar në konkursin për drejtor/esh dhe zëvendësdrejtor/esh të shkollave të mesëme të lartë, (SHML) dhe të shkollave fillore të mesëm të ultë, (SHFMU) të shpallur nga NjMBNj-ja në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Suharekës.

1.2 Komisioni është ad hoc dhe mandati i ti përfundon me nxjerrjen e vendimit/eve përfundimtare/ për përzgjedhjen e kandidatit/ve në pozitën/at e kërkuara me konkurset e latëcekuara dhe ka këtë përbërje:

1.2.1 Begishe BASHA----------përfaqësuese e DKA-së----------kryesuese
1.2.2 Jeton VRANOCI----------drejtor i shkollës----------anëtar
1.2.3 Anëtari i tretë vjen nga MASHTI, sipas Rregullores (QRK), Nr.19/2024.
1.2.4 Anëtar dy përfaqësues të këshillit drejtues nga IEAA-AP, një prind dhe një mësimdhënës në cilësinë e vëzhguesve pa të drejt vote në se cilin institucion ku është duke u zhvilluar procedura e konkursit.

Neni 2

Detyrë e këtij komisionit përzgjedhës është që të bëjë intervistimin e kandidatëve të cilit kanë konkurruar në këtë konkurs dhe në bazë të pikëve të fituar, bën ranglistën e kandidatëve dhe i rekomandon Kryetarit të Komunës për zgjedhjen e drejtorit të shkollës sipas konkurseve.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË

01-Nr- 410-44606
Më datë 31.08.2026

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI